

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dilese / Izlaze: Date / Data: 04.04.2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 22	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.22
 Data: 28.03.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR.01.NR.109 TË DATËS
30.09.2019

I

Me këtë vendim plotësohet - ndryshohet Vendimi me Nr: 01.Nr.109 i datës 30.09.2019, përmes së cilit është bërë këmbimi i pronës së Komunës dhe subjektit juridik Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Luftës.

II

Pika IV e Vendimit me Nr. 01. Nr.109 të datës 30.09.2019, ndryshohet vetëm për sa i përket afatit të pagesës së qirasë ashtu që afati prej 3 viteve ndryshohet si në vijim; Komuna e Ferizajt Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës do t'i paguaj qiranë deri në përfundim të ndërtimit të objektit të Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës.

III

Pikat tjera të vendimit Nr.01. Nr.109 të datës 30.09.2019 të cilat nuk preken nga ky Vendim mbesin në fuqi.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Izdalese / Izlaze: Date / Dana: 09.04.2025

Nr. Org. / Org. jed. 01	Nr. Prot. / Br. Prot. 23	Nr. Faqeve. / Br. Strana. 1
-------------------------	--------------------------	-----------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.23
Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E BUSTIT TË DËSHMORIT HYSNI KAJTAZI

I

Lokacioni për ndërtimin e bustit të Dëshmorit Hysni Kajtazi në Fshatin Tërrn caktohet në parcelën kadastrale 584-1 Z.K. Tërrn me sipërfaqe 200 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të bustit të Dëshmorit Hysni Kajtazi në Fshatin Tërrn.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e bustit të Dëshmorit Hysni Kajtazi në Fshatin Tërrn do të bëhet nga banorët e fshatit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datede / Izlaze: Date / Dana: 09.04.2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 24	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.24
 Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE PËR TË ZHDUKURIN E LUFTËS RRUSTEM RRUSTEMI

I

Lokacioni për ndërtimin e pllakës përkujtimore Rustem Rustemi në Fshatin Slivovë caktohet në parcelën kadastrale 683-0 Z.K. Slivovë me sipërfaqe 200 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis, të lëshoj leje ndërtimore për ndërtimin e pllakës përkujtimore Rustem Rustemi në Fshatin Slivovë.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e pllakës përkujtimore Rustem Rustemi në Fshatin Slivovë do të bëhet nga banorët e fshatit.


IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


 Xhayit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Udhëzime / Izlaze: Date / Data: 04.04.2025		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 25	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr.25
 Data: 28.03.2025**

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM TË PJESËVE TË NGASTRËS
 KADASTRALE; 835-0 DHE 834-0 Z.K. NERODIME E ULËT PRONË PRIVATE.**

I

Shpalljen Interes i Përgjithshëm - Publik pjesët e ngastrave kadastrale:

- 834-0 Z.K. Nerodime e Ulët, me sipërfaqe prej 5758 m², pronë e Sabedin (Hajdin) Muhaxheri.
- 835-0 Z.K. Nerodime e Ulët, me sipërfaqe prej 5448 m², pronë e Sabedin (Hajdin) Muhaxheri.

II

Ngastrat kadastrale Shpallen Interes i Përgjithshëm - Publik me qëllim të krijimit të hapësirës për varreza të Fshatit Manastirc, varreza të cilat do t'i shfrytëzojnë të gjithë banorët e fshatit nga të gjitha lagjet.

III

Obligohet: Drejtoria e Financave që të planifikojë buxhet, në buxhetin e Vitit 2026 -2027 për shpronësim të ngastrave kadastrale të përshkruara më lartë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBILA

Datëse - Izlaze: Date / Dana: 04.04.2025

Nr. Orgv. Org. jed.	01	Nr. Prot. Br. Prot.	26	Nr. Faqev. Br. Strana.	2
------------------------	----	------------------------	----	---------------------------	---

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.26
Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Parag.4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM-PUBLIK TË PJESËVE TË NGASTRËS
KADATSRAL: 3538-0 DHE 3539-0 Z.K. FERIZAJ

I

Shpallen interes i përgjithshëm ngastrat kadastrale:

- 3538-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 173 m², pronë e Barije (Smail) Sahiti,
- 3539-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 115 m², pronë e Barije (Smail) Sahiti.

II

Ngastrat kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik me kërkesë të palës e cila mund të shfrytëzohet për zgjerimin e rrugës “Enver Topalli” dhe “Imri Halili”, pra qëllimi i shpalljes interes publik është rregullimi –organizimi i parcelave private si dhe zgjerimi i rrugës “Enver Topalli” dhe “Imri Halili”.

III

Pjesa e parcelës kadastrale 3538-0 dhe 3539-0 Z.K. Ferizaj, propozohen që të këmbehen me pjesën e ngastrës kadastrale 1043-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt.

IV

Pronat të cilat shpallen interes i përgjithshëm – publik janë të regjistruara 3538-0 dhe 3539-0 Z.K. Ferizaj në pronësi të Barije (Smail) Sahiti, në këtë parcelë nuk ka ndonjë kontest apo vërejtje.

V

Obligohet: Kryetari i Komunës – Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të kërkoj vlerësim të njësive kadastrale të përshkruara më lartë nga Ministria e Financave – Departamenti i Tatimit në Pronë, dhe pas vlerësimit të njësive të sjell në Kuvend të Komunës Propozimin për Këmbimin të këtyre njësive.

VI

Ky vendim nuk ka titull ekzekutiv dhe i njëjti shërben vetëm për vlerësimin e paluejtshmërive.

VII

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës-Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

VIII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Datese / Izlaze: Date / Dana: 04.04.2025

Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 27 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.27
Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E LAPIDARIT TË DËSHMORIT GËZIM SAHITI

I

Lokacioni për ndërtimin e bustit të Dëshmorit Gëzim Sahiti në Fshatin Pojatë caktohet në parcelën kadastrale 228-2 Z.K. Pojatë me sipërfaqe 300 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të bustit të Dëshmorit Gëzim Sahiti në fshatin Pojatë.

III

Ndërtimi dhe financimi për lapidarin e lartëcekur bëhet nga banorët e Fshatit Pojatë.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kreytari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 04/09/2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 28 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.28
Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave, nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139, me ndryshime dhe plotësime të Ligjit numër 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24. Paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR SHPALLJEN INTERES I PËRGJITHSHËM - PUBLIK TË PJESËS SË NGASTRËS KADATSRALË 721-0 Z.K.NEKODIM.

I

Shpallen Interes i Përgjithshëm-Publik pjesa e ngastrës kadastrale 721-0 Z.K. Nekodim me sipërfaqe 1426 m² (14 ari e 26 m²), pronë e subjekti juridik "Daakonn" SH.P.K., me Nr. Identifikues 811553222, nënqirambajtje 99 vite.

II

Ngastrat kadastrale Shpallet Interes i Përgjithshëm-Publik sepse e njëjta është marr nga Komuna e Ferizajt me rastin e implementimit të nënkalimit për vetura në Fshatin Nekodim.

III

Pjesa e ngastrës kadastrale 721-0 Z.K. Nekodim me sipërfaqe 1426 m² do të kompensohet nga Komuna në formën që pala do të paraqes si kërkesë për kompenzim në pajtueshmëri me ligjet në fuqi.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës - Drejtoia për Urbanizëm, Mjedis dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi


REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Data / Dana: 09.04.2025		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 29	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.29
 Data: 28.03.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligji Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT, PËR VENDOSJE - NDËRTIMIN E PÛRKOHSHËM TË
ZYREVE TË ORGANIZATËS "MIQTË E FAMILJES BIDEN" - FERIZAJ

I

Lokacioni për ndërtimin e zyreve dhe dy klasëve mësimore të OJQ "Miq të familjes Biden – Ferizaj" caktohet në parcelën kadastrale 131-1 Z.K. Sojevë me sipërfaqe 200 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedisit të lëshojë leje të përkohshme ndërtimore për ndërtimin – vendosjen e përkohshëm të zyreve të Organizatës "Miq të familjes Biden" – Ferizaj.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e përkohshëm të zyreve të Organizatës "Miq të familjes Biden" – Ferizaj, do të bëhet nga Organizata "Miq të Familjes Biden" në bashkëpunim me KFOR-in.

IV

Afati për vendosje të zyreve është 10 vite, nëse organizata pushon aktivitetin, apo ndryshon veprimtarin brenda 10 viteve është e obliguar që të liroj pronën komunale ose në të kundërtën objekti montazh me të gjitha elementet përcjellëse do të regjistrohet në emër të komunës.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

 Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë - Izlaze: Date / Dana: 04/04/2025		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 30	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.30
 Data: 28.03.2025

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194 dhe me Ligji Nr. 08/L332 Mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025, Neni 9 pika 7. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë Vitit 2024 dhe të regjistruara në SIMFK që kalojnë shumat e të hyrave të ndara në tabelën 4.1 për Vitin 2024, barten në Vitin 2024 me vendim të Kuvendit të Komunës.

Të hyrat vetanake të Vitit 2024 të cilat do të barten në Vitin 2025 janë në shumën prej **2,277,102.28€**. Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, Ligjit të buxhetit për Vitin 2025 dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nga teprica e mjeteve nga viti paraprak që barten në vitin vijues paguhen obligimet e organizatës buxhetore.

Nisur nga kjo, propozimi ynë për shpërndarjen e tyre në kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe në programet buxhetore si më poshtë. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 miratoi:

VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE THV NGA VITI 2024 NË VITIN 2025

I

Miratohet: Propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr: 01.Nr.63/25 i datës 20.03.2025 për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2024 në Vitin 2025.

II

Gjithësej bartet nga Viti 2024 në Vitin 2025 shuma prej **2,277,102.28€**.

III

Shpërndarja e mjeteve të bartura do të realizohet si më poshtë:

Kategoritë ekonomike:

Mallra dhe shërbime 951,175.28€
 Subvencione dhe transfere 744,000.00€
 Investimet kapitale 431,927.00€
 Shpenzimet komunale 150,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime:

Administrata (16332) shuma prej 250,000.00 €
 Tatimi në pronë (17572) shuma prej 201,175.28€

Kujdesi primar shëndetësor (74900) shuma prej 250,000.00€
Administrata e arsimit (92160) shuma prej 250,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve komunale:

Administrata (16332) shuma prej 150,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere:

Zyra e kryetarit (16032) shuma prej 100,000.00€
Administrata e shëndetësisë (73041) shuma 94,000.00€
Administrata e arsimit (92160) shuma prej 550,000.00€

Në kategorinë e shpenzimeve kapitale:

Infrastruktura rrugore (18032) Shuma prej 100,000.00€ në projektin me kod **88773** Shtrurja e rrugëve me zhavor - hapja e rrugëve të reja

Infrastruktura publike (18192) në shuma prej 50,000.00€ në projektin me kod **53029** Rregullimi i shtretërve të lumenjeve dhe kanaleve ujore në Talinovec, Koshare, Terrn , Pleshinë, Greme, Gaçkë

Turizmi (48072) shuma prej 241,927.00€ në projektin me kod **53097** Ndertimi i infrastrukturës së zonave turistike në Jezerc

Kultura, Rinia dhe Sportet (85112) shuma prej 40,000.00€ në projektin me kod **54782** Ndërtimi i tribunave në stadiumin "Tefik Çanga" në fshatin Tërrn.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave si dhe Kryetari i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi